



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë _____.____.2025

PËR

**PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË HOLLËSISHME PËR FUNKSIONIMIN E
KOMISIONIT TË SHQYRTIMIT TË ANKIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 55 pika 5, të ligjit nr. 99/2024, datë 12.09.2024, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim përcakton rregullat e hollësishme për organizimin, funksionimin dhe vendimmarrjen e komisionit të shqyrtimit të ankimit, sipas parashikimeve në ligjin nr. 99/2024, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë".
2. Në kuptim të këtij vendimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:
 - a) "Komisioni i shqyrtimit të ankimit", më poshtë "*Komisioni*" është organ kolegjal i ngritur pranë Inspektoratit të Përgjithshëm, i cili shqyrton ankimin administrativ, të paraqitur nga subjekti i inspektimit kundër vendimit përfundimtar të inspektimit;
 - b) "Strukturat e tjera inspektuese", janë struktura që kryejnë funksione inspektimi në juridiksionin e pushtetit ekzekutiv të qeverisjes qendrore dhe që janë në fushë zbatimin e ligjit nr. 99/2024, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë";
 - c) "Subjekti i inspektimit", është çdo person fizik apo juridik, privat apo publik, i cili kryen veprimtari tregtare, ekonomike, profesionale apo veprime të tjera dhe që ka detyrimin të respektojë kërkesat ligjore në fushën e inspektimit;
 - ç) "Vendimi përfundimtar i inspektimit", është vendimi, i cili merret nga trupa inspektuese, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 99/2024, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë";
 - d) "Vendimi i komisionit të shqyrtimit të ankimit", është vendim përfundimtar në nivel administrativ dhe mund të ankimohet vetëm në rrugë gjyqësore.
3. Në ushtrimin e funksioneve të parashikuara në ligjin për inspektimin dhe në këtë vendim, Komisioni udhëhiqet nga këto parime:

- a) Parimi i ligjshmërisë;
 - b) Parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit;
 - c) Parimi i pavarësisë dhe paanësisë në vendimmarrje;
 - ç) Parimi i transparencës dhe informimit;
 - d) Parimi i mbrojtjes së të dhënave dhe konfidencialitetit;
 - dh) Parimi i objektivitetit;
 - e) Parimi i ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit administrativ;
 - ë) Parimi i proporcionalitetit;
 - f) Parimi i procesit të rregullt ligjor, që garanton të drejtën për t'u informuar, për të kërkuar sqarime rreth fakteve, për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur.
4. Çdo çështje që nuk parashikohet në këtë vendim rregullohet sipas Kodit të Procedurave Administrative dhe ligjit nr. 99/2024, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë".

KREU II

ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I KOMISIONIT TË SHQYRTIMIT TË ANKIMIT

1. Komisioni i shqyrtimit të ankimit organizohet si strukturë *ad hoc*, që ngrihet për shqyrtimin e ankimeve të paraqitura nga subjektet kundër vendimeve përfundimtare të inspektimit.
2. Komisioni i shqyrtimit të ankimit, ngrihet me urdhër të inspektorit të Përgjithshëm dhe ka në përbërje 5 (pesë) anëtarë, si më poshtë:
 - a) dy përfaqësues nga Inspektorati i Përgjithshëm, ku njëri prej tyre kryeson komisionin;
 - b) një përfaqësues nga ministria përgjegjëse e inspektoratit qendror ose strukturës përgjegjëse për inspektimin, ndaj vendimmarrjes së të cilit/cilës është drejtuar ankimi administrativ;
 - c) një përfaqësues nga inspektorati qendror/struktura përgjegjëse për inspektimin, ndaj vendimmarrjes së të cilit/cilës është drejtuar ankimi administrativ;
 - ç) një përfaqësues nga organizata joqeveritare me aktivitet në fushën e biznesit apo nga organet e përfaqësimit të biznesit.
3. Anëtarët e përcaktuar nga Inspektorati i Përgjithshëm, sipas shkronjës "a" të pikës 2, të këtij kreu janë në pozicion zëvendësinspektor i Përgjithshëm ose drejtor drejtorie. Anëtar i përcaktuar sipas shkronjës "b", të pikës 2, të këtij kreu është në pozicion drejtor drejtorie. Anëtar i përcaktuar sipas shkronjës "c" të pikës 2, të këtij kreu është në pozicion kryeinspektor qendror ose drejtor drejtorie në drejtorinë qendrore të inspektoratit qendror.
4. Anëtar i komisionit sipas përcaktimit në shkronjën "ç", të pikës 2, të këtij kreu duhet të jetë përfaqësues i organizatave joqeveritare me aktivitet në fushën e biznesit apo nga organet e përfaqësimit të biznesit, i cili përzgjidhet duke u bazuar në kriteret e mëposhtme:
 - a) Të jetë propozuar nga një ose më shumë shoqata të regjistruara ligjërisht, që përfaqësojnë interesat e subjekteve private në sektorin përkatës;
 - b) Të ketë eksperiencë të dëshmuar në fushën e marrëdhënieve me biznesin ose në fushën e legjislacionit;
 - c) Të mos ketë konflikt interesi me subjektet që paraqesin ankimet administrative apo me inspektorët

që kanë vendosur masën administrative.

5. Përfaqësuesi i biznesit sipas përcaktimit të pikës 4, të këtij kreu, pas shqyrtimit të propozimeve dhe verifikimit të përmbushjes së kriterëve të përcaktuara në këtë vendim nga Inspektorati i Përgjithshëm, bëhet pjesë e listës së përfaqësuesve për të qenë anëtar i komisionit të shqyrtimit të ankimit.

6. Anëtarët e komisionit duhet të kenë kualifikim sipas fushës dhe natyrës së objektit të ankimit që trajtohet nga komisioni.

7. Për të garantuar funksionimin në kohë dhe me cilësi, inspektori i Përgjithshëm miraton paraprakisht një listë të përfaqësuesve të mundshëm, të cilët plotësojnë kriteret për t'u përfshirë në komision si anëtarë.

8. Për shqyrtimin e ankimit administrativ, përbërja konkrete e komisionit caktohet nga inspektori i Përgjithshëm, duke zgjedhur anëtarët nga lista e miratuar, sipas natyrës së çështjes, fushës së inspektimit dhe për të shmangur konfliktin e interesit.

9. Komisioni *ad hoc* funksionon për afatin e caktuar të shqyrtimit të ankimit administrativ dhe shpërbëhet pas marrjes së vendimit.

10. Anëtarët e komisionit të shqyrtimit të ankimit duhet të tërhiqen nga shqyrtimi i ankimit administrativ në rastet kur ekzistojnë një nga pengesat ligjore të parashikuara në nenin 30, të Kodit të Procedurave Administrative.

11. Për rastet kur konstatohet pamundësia e vijimit të ushtrimit të funksioneve të njërit prej anëtarëve të komisionit, sipas përcaktimit në pikën 10, të këtij kreu, inspektori i Përgjithshëm, cakton zëvendësuesin e tij me një nga anëtarët, sipas listës së miratuar paraprakisht, brenda një afati prej 3 ditë pune, nga momenti i konstatimit të këtij fakti.

KREU III

KOMPETENCAT DHE DETYRAT E KOMISIONIT TË SHQYRTIMIT TË ANKIMIT

1. Komisioni i shqyrtimit të ankimit kryen të gjitha veprimet e nevojshme, me qëllim realizimin e një hetimi administrativ të plotë dhe të gjithanshëm, në përputhje me përcaktimet e Kodit të Procedurave Administrative dhe ligjit nr. 99/2024, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë".

2. Përpara fillimit të seancës për shqyrtimin e ankimit administrativ, kryetari dhe anëtarët e komisionit plotësojnë formularin e deklarimit të konfliktit të interesit.

3. Komisioni e ushtron veprimtarinë e tij në mënyrë kolegjiale, sipas rregullave dhe procedurave të parashikuara në legjislacionin për organizimin dhe funksionimin e organeve kolegjiale, me përjashtim të rasteve kur është parashikuar ndryshe në këtë vendim.

4. Kryetari i komisionit ushtron këto detyra:

a) cakton datën e zhvillimit të mbledhjes së komisionit dhe vendos për rendin e ditës së çdo mbledhje;

b) drejton zhvillimin e mbledhjeve të komisionit;

c) mbikëqyr veprimtarinë e sekretariatit teknik të komisionit;

ç) ruan konfidencialitetin e informacionit të marrë gjatë ushtrimit të funksioneve të tij;

d) deklaron në mbledhjen e radhës, para votimit të çdo çështjeje, nëse ai apo anëtarët e komisionit janë në kushtet e konfliktit të interesit;

dh) u jep fjalën anëtarëve të komisionit ose palëve në proces për të paraqitur pretendimet dhe sqarimet e tyre;

e) cakton relatorin e çështjes, i cili është një nga përfaqësuesit e Inspektoratit të Përgjithshëm.

4. Anëtar i Komisionit ushtron këto detyra:

a) merr pjesë në mbledhjet e Komisionit;

b) deklaron gjendjen në kushtet e konfliktit të interesit;

ç) ruan konfidencialitetin e informacionit të marrë gjatë ushtrimit të funksionit;

d) voton për çështjet e rendit të ditës;

dh) nënshkruan vendimin e komisionit, në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative dhe legjislacionin në fuqi.

5. Me përfundimin e shqyrtimit të ankimit, Komisioni merr vendimin dhe e nënshkruan menjëherë.

6. Komisioni i shqyrtimit të ankimit, mbështetet nga Sekretariati Teknik, përbërja e të cilit caktohet me urdhër të inspektorit të Përgjithshëm.

7. Sekretariati teknik ka këto detyra dhe përgjegjësi:

a) verifikon dokumentacionin për shqyrtimin e ankimit administrativ, përgatit dosjen që lidhet me rendin e ditës së mbledhjes me të gjitha faktet dhe provat e administruara me çështjen objekt ankimi dhe ia paraqet komisionit përpara fillimit të mbledhjes;

b) përpilon njoftimet për mbledhjen e komisionit;

c) paraqet informacion lidhur me subjektin dhe përmbajtjen e ankimit, si dhe dokumentacionin përkatës;

ç) mban procesverbalin e mbledhjeve, i cili zbardhet brenda 2 ditëve pune dhe nënshkruhet nga sekretariati teknik

d) i paraqet Inspektorit të Përgjithshëm, brenda 2 ditëve pune, vendimin e nënshkruar nga komisioni, procesverbalin e mbajtur dhe dokumentacionin e çështjes;

dh) ngarkon në sistemin elektronik "e-Inspektimi" vendimin e arsyetuar të marrë nga komisioni, aktet e mbajtura gjatë shqyrtimit të ankimit dhe të gjithë dokumentacionin e çështjes.

8. Me nxjerrjen e urdhrit të Inspektorit të Përgjithshëm për ngritjen e komisionit të shqyrtimit të ankimit, sekretariati teknik i vë në dispozicion relatorit të komisionit, dosjen e ankimit, objekt shqyrtimi.

9. Kryetari i komisionit, brenda 5 ditëve pune nga urdhri i inspektorit të Përgjithshëm për ngritjen e komisionit, njofton anëtarët për datën dhe orën e shqyrtimit të ankimit.

10. Kur nuk plotësohet kuorumi i nevojshëm për mbledhjen e komisionit, kryetari vendos thirrjen e mbledhjes në një ditë tjetër të afërt. Në raste përjashtimore, kur mungesa e anëtarit të komisionit është pa shkaqe të arsyeshme, komisioni e shqyrton ankimin me një trupë me jo më pak se 3 (tre) anëtarë. Në rast se numri i anëtarëve është 4 (katër) dhe votimi është i barabartë, vota e kryetarit është përcaktuese në marrjen e vendimit.

11. Në rast se subjekti i inspektimit ose përfaqësuesi ligjor i tij nuk është i pranishëm, komisioni vlerëson shkaqet e mosparaqitjes në seancë. Nëse mosparaqitja ka ndodhur për shkaqe që nuk vlerësohen të arsyeshme, komisioni vendos zhvillimin e seancës pa praninë e subjektit ose përfaqësuesit të tij. Në rastet kur vlerësohet se subjekti i inspektimit ka paraqitur shkaqe të arsyeshme, apo shkaqe të cilat vlerësohen si të tilla, kryetari shtyn mbledhjen duke kryer një njoftim të dytë për një datë sa më të afërt. Në rast se edhe në këtë datë, subjekti i njoftuar rregullisht dhe/ose përfaqësuesi i tij nuk paraqiten para komisionit, vendoset vazhdimi i seancës në mungesë.

KREU IV ANKIMI ADMINISTRATIV

1. Çdo subjekt që pretendon, se i është cenuar një e drejtë apo një interes i ligjshëm nga një vendim përfundimtar inspektimi, ka të drejtë të bëjë ankim administrativ kundrejt këtij vendimi.
2. Ankimi i paraqitet komisionit të shqyrtimit të ankimit, pranë Inspektoratit të Përgjithshëm brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit përfundimtar, përveçse kur parashikohet ndryshe në ligjin e posaçëm.
3. Ankimi drejtuar Komisionit paraqitet në gjuhën shqipe në përputhje me rregullat e përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative. Në çdo rast, ankimi administrativ që përmbush kriteret ligjore pranohet në çdo formë të paraqitur nga subjekti i inspektimit.
4. Ankimi i administruar në formë elektronike, printohet dhe regjistrohet në protokollin e Inspektoratit të Përgjithshëm.
5. Regjistrimi i ankimit administrativ nuk mund të refuzohet për asnjë shkak.
6. Subjekti ankimues mund të kërkojë rivendosjen në afat sipas afateve dhe përcaktimeve në Kodin e Procedurave Administrative. Kërkesa i drejtohet inspektorit të Përgjithshëm, i cili urdhëron ngritjen e komisionit të shqyrtimit të ankimit.
7. Shqyrtimi i kërkesës për rivendosje në afat bëhet nga komisioni i shqyrtimit të ankimit në mbledhjen më të afërt të tij dhe vendimi pasqyrohet në procesverbal, si dhe i njoftohet subjektit.
8. Kundër vendimit të komisionit për mospranimin e kërkesës për rivendosjen në afat, mund të bëhet ankim sipas rregullave të përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative.

KREU V PROCEDURA E SHQYRTIMIT TË ANKIMIT ADMINISTRATIV

1. Me caktimin e çështjes, relatori verifikon paraprakisht kushtet formale të ankimit dhe i relaton fillimisht komisionit rezultatet e verifikimit lidhur me:
 - a) juridiksionin administrativ dhe kompetencën lëndore të Komisionit;
 - b) legjitimitimin e ankimuesit;
 - c) respektimin e afateve ligjore për ankimin;
 - ç) elementet e domosdoshme të ankesës sipas përcaktimeve në këtë vendim.
2. Komisioni, gjatë shqyrtimit paraprak, merr një nga vendimet e mëposhtme:
 - a) kthimin e ankimit për shkak të mungesës së kushteve formale të tij dhe i lë afat ankimuesit 5 ditë afat për plotësimin e dosjes së ankimit, sipas Kodit të Procedurave Administrative;
 - b) pranimin e ankimit, fillimin e procedurës së hetimit administrativ dhe kalimin e ankimit për shqyrtim të thelluar.
3. Nëse Komisioni merr vendim sipas shkronjës “b”, të pikës 2, të këtij kreu, vazhdon me shqyrtimin në themel të ankimit brenda së njëjtës mbledhje. Komisioni duhet të përfundojë shqyrtimin administrativ dhe të marrë vendimin, brenda 30 ditëve nga regjistrimi i ankesës në Inspektoratin e Përgjithshëm.
4. Afati për shqyrtimin e ankimit administrativ, sipas pikës 3, të këtij kreu, mund të shtyhet vetëm një herë, në rast të kompleksitetit të çështjes deri në 10 ditë kalendarike.

5. Komisioni shqyrton ankimin administrativ në prani të subjektit të inspektimit, përfaqësuesit ligjor të tij ose një personi të autorizuar me dokumentacionin përkatës ligjor nga subjekti i inspektimit.
6. Në përfundim të procesit të shqyrtimit të ankimit administrativ dhe pasi të gjithë anëtarët kanë shprehur mendimin e tyre mbi çështjen, kryetari i Komisionit deklaron mbylljen e shqyrtimit administrativ të ankimit dhe fton anëtarët që të votojnë.
7. Secili anëtar ka të drejtën e një vote dhe abstenimi nga votimi nuk lejohet për asnjë anëtar të komisionit.
8. Vendimet në Komision merren me shumicën e votave, nëpërmjet votimit të hapur.
9. Në përfundim të procesit, Komisioni merr një nga vendimet e mëposhtme:
- a) lënie në fuqi të aktit administrativ, duke argumentuar zbatimin e drejtë të procedurave dhe ligjshmërinë në veprimet apo mosveprimet, për të cilat ankimuesi ka pretenduar shkelje;
 - b) shfuqizimin e aktit administrativ (vendimit të dënimit kryesor dhe atij plotësues nëse ka), duke argumentuar shkeljet e konstatuara në zbatimin e ligjit e të procedurave për inspektimin, duke treguar masat përkatëse për shfuqizimin e tyre dhe rivendosjen e ligjshmërisë në veprimet e inspektoratit qendror;
 - c) ndryshimin e vendimit pjesërisht duke argumentuar sipas rastit shkeljen e konstatuar në zbatim të ligjit për inspektimin dhe ligjit për marrjen e kundërvajtjes administrative.
10. Secili nga anëtarët ka të drejtë që mendimin e vet në pakicë, të argumentuar t'ia bashkëlidhë mendimit të shumicës.
11. Kundër vendimit të komisionit, subjekti mund të bëjë ankim në gjykatën administrative brenda 45 ditëve nga data e marrjes së njoftimit të vendimit.
12. Kur konstatohen gabime materiale në një vendim të komisionit të ankimit, bëhet ndreqja e gabimit me anë të një shtojce vendimi, duke cituar gabimin material të bërë gjatë zbardhjes së vendimit, duke bërë referencën tek burimi i saktë dhe duke specifikuar se është i njëjti vendim i marrë mbi të njëjtat dokumente të inventarizuara në dosje, në kohën e shqyrtimit dhe marrjes së vendimit.
12. Për çdo mbledhje të Komisionit procesverbali përmban një përmbledhje të parashtrimeve në mbledhje, datën dhe vendin e mbledhjes, anëtarët që morën pjesë, pjesëmarrjen e subjektit që ka paraqitur ankimin administrativ apo përfaqësuesi, çështjet që u diskutuan, arsyet e votimit pro ose kundër, vendimet që u morën, si dhe formën dhe rezultatin përfundimtar të vendimit.
13. Vendimi i Komisionit përmban numrin, datën, nënshkrimin, anëtarët e pranishëm në mbledhje, relatorin e çështjes, votimin kundër, si dhe në mënyrë të shprehur rregullat për ushtrimin e së drejtës së ankimit në gjykatë. Arsyetimi i vendimit kundër i bashkëlidhet vendimit.
14. Përfaqësimi në proceset gjyqësore, të cilat kanë objekt kundërshtimin e vendimit të komisionit të ankimit ushtrohet nga punonjësit e Inspektoratit të Përgjithshëm dhe inspektoratit qendror përkatës, me pozicionin e punës jurist ose çdo punonjës tjetër me autorizim të titullarëve të institucioneve.
15. I gjithë dokumentacioni i krijuar gjatë procedurës së shqyrtimit të ankimit administrativ arkivohet sipas rregullave të përcaktuara në legjislacionin për arkivën.

KREU VI

DISPOZITA TË FUNDIT DHE KALIMTARE

1. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Inspektorati i Përgjithshëm, ministritë e linjës, inspektoratet qendrore, strukturat e tjera përgjegjëse për inspektimin, organizatat joqeveritare me aktivitet në fushën e biznesit apo organet e përfaqësimit të biznesit.

2. Ngarkohen institucionet e përcaktuara në pikën 1, të këtij kreu, të caktojnë përfaqësuesit e tyre për të qenë pjesë e listës së anëtarëve të komisionit të shqyrtimit të ankimit, brenda 10 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Inspektorati i Përgjithshëm, brenda 10 ditëve nga paraqitja e propozimeve nga ministritë e linjës, inspektoratet qendrore, strukturat e tjera përgjegjëse për inspektimin, organizatat joqeveritare me aktivitet në fushën e biznesit apo organet e përfaqësimit të biznesit, të miratojnë listën e përfaqësuesve sipas përcaktimeve në këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama